



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr 3561/Prot
3

B.curri, me 5.8.2025

NJOFTIM PER KONSULTIM PUBLIK

Titulli i Projekt-aktit : *Plani i Arsimit Parauniversitar*

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe në kuadër të garantimit të pjesëmarrjes së publikut në proceset vendimmarrëse të pushtetit vendor, Keshilli Bashkiak Tropojë, fton të gjithë qytetarët, përfaqësuesit e institucioneve arsimore, organizatat e shoqërisë civile, përfaqësues të këshillave prindërorë dhe të gjithë aktorët e interesuar, të marrin pjesë në dëgjuesën publike për prezantimin dhe miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar për Bashkinë Tropojë

☑ Data: 01 Shtator 2025

☑ Ora: 12:00

☑ Vendi: Salla e Mbledhjeve te Keshillit Bashkiak Bashkia Tropojë

Ky plan strategjik përfaqëson një dokument të rëndësishëm për drejtimin, zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit arsimor parauniversitar në territorin e Bashkisë Tropojë për vitet në vijim. Synimi është të rritet cilësia e edukimit, të sigurohet akses i barabartë për të gjithë nxënësit dhe të forcohet bashkëpunimi ndërinstitucional në fushën e arsimit.

Ftojme të gjithë të interesuarit të marrin pjesë dhe të japin mendimet, propozimet apo sugjerimet e tyre.

Për më shumë informacion, ju lutem kontaktoni në adresën zyrtare të Bashkisë Tropojë:

☑ Email: nfo@tropoje.gov.al

**SEKRETAR KESHILLI
Ergent GJONGECAJ**

